



Australian Government

Department of Health

Një vegël e re për të ndihmuar ngadalësimin e përhapjes së COVID-19

Aplikacioni COVIDSafe është një vegël e re, krahas testimit, higjienës së mirë dhe distancimit social, për të ndihmuar ngadalësimin e përhapjes së koronavirusit në Australi.

Aplikacioni COVIDSafe në veçanti është për shëndetin. Ai do të ndihmon që australianët të qëndrojnë të sigurt duke përshpejtuar procesin e njoftimit të njerëzve që kanë qenë në kontakt me dikë që ka koronavirus. Zyrtarët shëndetësorë të shtetit dhe territorit do t'ju kontaktojnë juve nëse keni qenë të ekspozuar dhe do ju thonë:

- si të kujdeseni
- nëse ka nevojë të qëndroni në karantinë
- si, kur dhe ku të testoheni, dhe
- si të mbron veten dhe familjen tuaj.

Aplikacioni është në bazë vullnetare dhe falas. COVIDSafe mund ta zbrisni nga shitoret e juaja të aplikacioneve (app stores). Do ju kërkohet të futeni emrin, numrin tuaj të telefonit, kodin postar dhe grupmshën tuaj. Këto informacione do të ngarkohen në një sistem më të sigurt për ruajtjen e të dhënave dhe do të përdoren për të gjeneruar një kod referimi.

Aplikacioni operon në prapavijë të telefonit tuaj gjatë ditës. Ai përdor "Bluetooth" për të gjetur përdorues tjerë të aplikacionit. Ai në mënyrë të sigurt logon kodet e referimit të përdoruesve të aplikacionit me të cilët vini në kontakt, krahas datës, kohës, distancës dhe kohëzgjatjes së kontaktit.

Ai nuk regjistron lokacionin.

Këto informacione të kontaktit kodohen dhe ruhen në aplikacionin e telefonit tuaj. As ju nuk mund të keni qasje në ate.

Informacionet e kontaktit ruhen në aplikacion vetëm për 21 ditë. Kjo periudhë mundëson periudhën e inkubimit prej 14 ditë të virusit, si dhe kohën e nevojshme për të konfirmuar një rezultat pozitiv të testit. Informacionet më të vjetra se 21 ditë në aplikacion fshihen në mënyrë automatike.

Nëse jeni i diagnostifikuar me COVID-19, zyrtarët shëndetësor të shtetit dhe territorit do të kërkojnë informacione për të gjithë ata që i keni takuar kohët e fundit. Mund të zgjedhni që t'ju jepni atyre qasje në informacionet e marrura nga aplikacioni për njerëzit me të cilët keni pasur kontakt të afërt – brenda 1.5 metra për 15 minuta apo më shumë.

Tani gjetja e njerëzve që kanë qenë të ekspozuar në virusin mbështetet tek njerëzit që mund të mbajnë mend me kë kanë qëndruar si dhe që dinë informacionet për kontakt të atyre njerëzve. COVIDSafe e kryen këtë proces më shpejtë dhe më saktë.

Informacionet në aplikacion mund të përdoren vetëm nga ana e autoriteteve shëndetësore të shtetit dhe territorit, dhe vetëm për të ndihmuar njoftimin e njerëzve që kanë qenë në kontakt me dikë që ka koronavirus. Do të ishte një vepër penale përdorimi i të dhënave të aplikacionit në çfarëdo mënyre tjetër.

Në çdo kohë mund të fshini aplikacionin dhe informacionet në atë nga telefoni juaj.

Kur të mbaron pandemia në Australi, përdoruesve do ju thuhet të fshijnë aplikacionin COVIDSafe nga telefonat e tyre. Kjo do të fshin të gjitha informacionet e aplikacionit në telefonin personal. Informacionet në sistemin për ruajtjen e informacioneve gjithashtu do të shkatërrohen në fund të pandemisë.

Përdorimi i aplikacionit do t'ju ndihmon qeveritarëve që më shpejtë të reduktojnë kufizimet se sa do të ishte e mundshme në rastin e kundërt.

Për më shumë informacione për koronavirusin dhe aplikacionin COVIDSafe, vizitoni www.health.gov.au